



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë 24.12.2021

Nr. 83, datë 24.12.2021

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT
TË BASHKISË SHIJAK PËR PERIUdhËN JANAR 2022 – DHJETOR 2022

Këshilli i Bashkisë në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Neni 119 “Programi i Punës së Këshillit Bashkiak” dhe sipas relacionit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Shijak për periudhën Janar 2022 – dhjetor 2022, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Shijak dhe Kryetari Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Tauland Xhera



SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Kozeta Doda